



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:124874

Datë: 09.11.2020

Numri i dokumentit: 01253485

P.nr. 1043/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit B. S.nga, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par. 1 te KPRK-së dhe veprës penale mashtrimi nga neni 335 par. 1 te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Pejë PP/II.nr.100/2019, të dt. 05.11.2019, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar të datës, 13.10.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Suada Hamza, të pandehurit B. S.në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 09.11.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B. S., i lindur me dt....., në, me vendbanim në, rr. “.....”, nr. .., i biri i S. dhe nënës M., e gjinisë V., i njohur sipas nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion-tregtar, i gjendjes se mesme ekonomike, posedon nr.tel., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

I - Me date 30.01.2018, ne fshatinK-, përpilon dokument te falsifikuar me qellim te shfrytëzimit te atij dokumenti si origjinal, ne atë mënyrë qe ne cilësi te pronarit te firmës “.....” Sh.P.K, me seli ne fsh. pasi qe ia shet te dëmtuarit V. A.nga, pronar i biznesit “.....” SHPK ne, kamionin e markës “.....” ne shumen prej 32000 euro, i pandehuri përpilon dy fatura te ndryshme ashtu qe faturën e pare ne emër te shitblerjes se automjetit te sipërshënuar e përcakton shumen prej 10.000 euro, te cilën shume i dëmtuari e paguan, ndërsa me rastin e dërgimit te faturës se dyte e përpilon nje fature fiktive me nr. 31218 te dt. 03.12.2018 ne emër te kompanisë NTSH “.....” ne fsh. K-....., nga përmbajtja e se cilës ne emër te derivateve “.....” në sasi prej 21359.22 litra , ne shumen prej 22.000 euro te cilën i pandehuri ia dërgon te dëmtuarit,

- Me çka ka kryer vepër penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPRK-së.

II. – ne kohen dhe vendin e njëjte si ne dispozitivin e I- rë, te kësaj aktakuze i pandehuri me ane te paraqitjes se rreme te fakteve apo duke fshehur faktet me qellim te përfitimit te kundërligjshëm te dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, e mashtron te dëmtuarin ne atë mënyrë qe meqenëse i dëmtuari kishte detyrim ndaj te pandehurit shumen prej 22.000 euro, ne emër te blerjes se kamionit ashtu qe pasi i pandehuri ia dërgon faturën fiktive te sipër cekur, shërbimi i financave ne kuadër te firmës se te dëmtuarit e ekzekuton këtë pagese përmes sistemit 2E-Banking”, duke menduar se fatura ka te beje me kamionin e blere.

- Me çka ka kryer veprën penale te mashtrimit nga neni 335 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 21, 41, 43, 45,46,47,73, 74, 80, 398 par. 1, nenit 335 par. 1 te KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

- I. Për veprën penale nga dispozitivi i **I-rë** i këtij aktgjykimi i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **500 (pesëqind) euro**,
- II. Për veprën penale nga dispozitivi i **II-të**, i këtij aktgjykimi i shqipton dënim me gjobë në shumë prej **500 (pesëqind) euro**, dhe dënim me burg në kohëzgjatje **prej 3 (tre) muaj**, konform nenit 47 të KPRK-së, dënimi me burg prej 3 (tre) muaj, me pëlqimin e te pandehurit iu është zëvendësuar me dënim me gjobe dhe ne shumen prej **1500 (njëmijë e pesëqind)**

Konform nenit 80 te KPRK-së, te pandehurit i shqiptohet dënim unik me gjobë ne shumen prej 2500 (dymijë e pesëqind) euro, te cilin i pandehuri është i obliguar të paguaj brenda afatit prej 6 (gjashte) muaj, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që ne emër te programin e kompensimit të viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari V. (I.) A. me vendbanim ne rr.”.....” nr. –, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzë Pejë, PP/II.nr.100/19, të dt. 05.11.2019, kundër të pandehurit B. S.nga, për veprën penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par. 1 te KPRK-së dhe veprën penale mashtrimi nga neni 335 par. 1 te KPRK-së

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 13.10.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar prezentë kane qene prokurori i shtetit Suada Hamza dhe i pandehuri B. S.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta, dhe se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për të dy veprat penale të cilat i vihen në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, ka shprehur pendimin për veprat e kryera dhe ka premtuar se më nuk do të përsërisë vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës, dhe ka propozuar që si rrethanë lehtësues të merret pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: shënimi i zyrtarit i punuar nga hetuesi Shefqet Berisha dt. 11.12.2018, si dhe ai i dt. 05.12.2018, deklarata e dëshmitarit M. Sh. e dhënë pranë stacionit policor ne Peje me dt. 18.12.2018, deklarata e të pandehurit B. S.e dhënë pranë stacionit policor ne Peje me dt. 19.07.2018, deklarata e të dëmtuarit V. A. e dhënë pranë stacionit policor ne Peje me dt. 19.07.2018, fatura e falsifikuar me nr. 215/18, komunikimet përmes emailit, komunikimet përmes SMS-it, si dhe shkresat tjera, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit B. S., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPP-së dhe veprës penale mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPP-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe ato i ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 të KPP-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, shprehjen e pendimit për veprat e kryera, premtimin se nuk do të përsëris vepra tjera penale në të ardhmen, faktin se i njëjti nuk ka qenë i dënuar me parë për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj ti nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, po ashtu si rrethanë lehtësues gjykata mori faktin se i dëmtuari në deklaratën e dhënë në Prokurori ka deklaruar se pasi që ju kanë kthyer mjetet nuk e ndien vetën të dëmtuar, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konformë nenit 46 par 3 të KPRK-së, nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata dënimin me gjobë do të ja zëvendësoj me dënim me burg, duke ja llogaritur 1 (një) ditë burg, për 20 euro të gjobës.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.1043/19 dt. 09.11.2020**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate